




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr. 27, datë 02.10.2023

PËR

**SHTYRJEN PËR NJË SHQYRTIM TË MËVONSHËM, "PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME
INDUSTRIALE"**
SUBJEKTIT "DAYLUX" SH.P.K



Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. **Shtyrje, për një shqyrtim të mëvonshëm**, për arsye të marrjes së plotë të informacionit nga subjekti, se ku përfundojnë mbetjet përfundimtare industriale, pra cila është pika fundore e tyre dhe ku dekantohen ato. Për lejen për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale, subjektit "Daylux", me vendndodhje Njësia Administrative Bradashesh Elbasan Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin sipas KRGJSH

- X= 501561.421 ; Y= 4550288.286 ; Z= 86 m.m.n.d



Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shfrytëzimit sipas KRGJSH

- $X= 501561.421$; $Y= 4550288.286$; $Z= 86$ m.m.n.d

Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shkarkimit sipas KRGJSH

- $X= 501511.497$; $Y= 4550358.54$; $Z= 85$ m.m.n.d

- Prurja e kërkuar: $Q= 0.082$ l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

